



**VENDIM**

**Nr.49 Datë 06.07.2009**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“MALIDO ENERGJI” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma a, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma a, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.07.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k., për t`u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Dhe konstatoi:**

- Paraqitjen e aplikimit, konform përcaktimeve të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”,

**Vendosi:**

1. Të filloje procedurat për licensimin e shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “KLOS”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**